



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
GRAMSH**

Nr. 322 | prot
12

Gramsh, më 05.01.2021

Vendim

Nr. 07, dt, 29.01.2021

Për

Miratimin e sistemimit të pikëzimit për familjet që kërkojnë të përfitojnë nga programet sociale të strehimit(Blerje banesa të ndërtuara nga EKB).

Bazuar në ligjin nr.22/2018 “Për strehimin social” nen 15,48,të VKM nr.384,datë 12.06.2019,”Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për t,u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve,procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”,të ligjit nr.139/2015,datë 17.12.2015,”Për vetëqeverisjen vendore”,neni 8,pika 2;neni 24,pika 2,të relacionit të drejtorisë së shërbimeve publike dhe emergjencave civile,këshilli i bashkisë në mbledhjen e tij të datës 29.01.2021

Vendosi:

- I. Miratimin e sistemit të pikëzimit për familjet që kërkojnë të përfitojnë nga programet sociale të strehimit,blerje banese të ndërtuar nga EKB,sipas tabelës së mëposhtme:

FORMATI TIP I SISTEMIT TË PIKËZIMIT

Nr	Kriteret	Shkalla e vlerësimit
1.1	Kushtet e strehimit , në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi familjet që: A nuk disponojnë banesë në pronësi; B banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi; C banojnë në banesa që paraqesin rrezik shembjeje; D kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore;	20
1.2	Kushtet familjare , në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi:	10

A	familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna;	3
B	të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore;	3
C	familjet me më shumë se katër fëmijë;	2
Ç	bashkëshortët, mosha e përgjithshme e përbashkët e të cilëve arrin deri në 60 vjeç.	2
1.3	Kushtet sociale , në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi:	40
A	personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave;	6
B	individët me statusin e jetimit, që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesjes shoqërore dhe deri në moshën 30 vjeç;	5
C	familjet e mbeturë pastreha për shkak të lirimit të banesave ish-pronarëve;	0
Ç	emigrantët e rikthyer, punëtorët emigrantë dhe azilkërkuesit;	2
D	familjet e policëve të rënë në detyrë;	4
E	punonjësit e reparteve të ndërhyrjes së shpejtë (FNSH); ,RENEA.	4
Ë	punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;	2
F	viktimat e dhunës në familje;	3
G	viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit;	3
H	anëtarët e komunitetit rom; anëtarë të komunitetit egjiptian;	3
I	të miturit në konflikt me ligjin, sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, pas ekzekutimit të dënimit;	2
J	vajzat nëna;	4
K	individët që i përkasin komunitetit LGBTI, të cilët janë viktima për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor bazuar në vendimin e organikompetent, sipas legislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi që përcakton se si pasojë e diskriminimit individi nuk ka një strehim të përshtatshëm dhe që kanë të ardhura të pamjaftueshme ose që nuk kanë fare të ardhura, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 3 të këtij ligji.	2
1.4	Kushtet ekonomike , në bazë të të cilave përcaktohen familjet, sipas grupeve të të ardhurave, të përcaktuara në këtë ligj.	30
A	Familje me të ardhura mesatare,jane te ardhura mujore midis 100 dhe 120 % e te ardhurave mesatare.	15
B	Familje me të ardhura të ulëta jane te ardhura mujore midis 70 dhe 100 % e te ardhurave mesatare.	10
C	Familje me të ardhura shume te uleta jane te ardhura mujore me te uleta	5

	70 % e te ardhurave mesatare.	
	Totali	100

Pikët maksimale që mund të përfitojë një familje janë 100. Nuk mund të mblidhen brendapërpendresa një kriteri pikët:

1. Nga pika A deri në D të kriterit 1.1
2. Nga pika A deri në Ç të kriterit 1.2
3. Nga pika A deri në c të kriterit 1.4

Pikët nga A deri në K të kriterit 1.3 mund të mblidhen me njëra-tjetërën sipas rasteve me poshtë:

1. Pika A mund të mblidhet me njërin prej rasteve si më poshtë:
 - a) Me pikat B,D,H së bashku ose veçmas;
 - b) Vetëm me pikën Ç;
 - c) Vetëm me pikën F apo me pikën G
2. Pika B mund të mblidhet vetëm me pikën A.
3. Pika Ç mund të mblidhet vetëm me pikën A.
4. Pika D mund të mblidhet me pikat A e B së bashku ose me njëren prej tyre. Në total mbledhja e pikëve A,B,Ç dhe D nuk mund të rezultojë më e lartë se 40 pikë.

Shënim : Për familjet që do të klasifikohen me pikë të barabarta do të kenë prioritet familjet me numër më të madh pjestarësh.

- II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari bashkisë, drejtoria e shërbimeve publike dhe Komisioni i Strehimit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Konc.Xh.Gjini
Pranoi:G.Lena
Miratoi:G.Lena
Dosja nr. _____
Afati _____



Sekretari i Këshillit të Bashkisë

Xhulia GJINI



Kryetari i Këshillit të Bashkisë

Greta LENA

